



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 maj 2014  
Nr.ref.: VTK632/14

## VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA

në

**Rastin Nr. KI77/13**

Parashtrues

**Fatmir Rushiti**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.  
nr. 82/2011, të 15 marsit 2013**

## **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

### **Parashtruesi i kërkësës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Fatmir Rushiti (në tekstin e mëtejmi: parashtruesi), me vendbanim në komunën e Prishtinës, i përfaqësuar nga Shoqëria e avokatëve "Sejdiu & Qerkini", sh.p.k.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi kërkon shqyrtimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 82/2011, të 15 marsit 2013, i cili është pranuar nga parashtruesi më 15 mars 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se i është shkelur e drejta e parashtruesit nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nga neni 6 (E Drejta për Gjykim të Drejtë) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe të protokolleve të saj (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).
4. Gjithashtu, objekt i vlerësimit është parashresa e parashtruesit për térheqjen e kérkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 82/11.

## **Baza juridike**

5. Kérkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-21 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 31 maj 2013, parashtruesi e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjkata).
7. Më 31 maj 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI77/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI77/13, caktoi Kolegjin shqyrties të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 8 korrik 2013, Gjkata ia dërgoi një kopje të kérkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 5 shtator 2013, Gjkata e njoftoi parashtruesin, si dhe Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PTK), për regjistrimin e kérkesës dhe kerkoi që të informohet lidhur me statusin e punës së parashtruesit, si dhe a e ka zbatuar PTK-ja Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. l. nr. 426/06 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 18/2008, siç parashihet me marrëveshjen ndërmjet PTK-së dhe parashtruesit.
10. Më 23 janar 2014, parashtruesi ka dorëzuar në Gjykatë një parashtresë për térheqjen e kérkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të

Gjykatës Supreme, Rev. nr. 82/11, me arsyetimin se Gjykata Supreme, me Aktvendim PPC. nr. 6/2013, ka anuluar Aktgjykimin Rev. nr 82/11 dhe ka konstatuar se revizioni është tërhequr dhe ka lënë në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 18/2008.

11. Më 11 mars 2014, Koleksi shqyrues shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe i rekomandoi Gjykatës për heqjen e kërkësës nga lista.

### **Përbledhja e fakteve**

12. Më 24 nëntor 2006, parashtruesi, me padi pranë Gjykatës Komunale, ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm Vendimi i Komisionit Disiplinor të shkallës së parë, nr. 01-2281/06, i 4 tetorit 2006, dhe Vendimi i Komisionit Disiplinor i shkallës së dytë, nr. 02-2281/06, i 2 nëntorit 2006, me të cilin parashtruesit i është shqiptuar masa ndërprerje e marrëdhënieς së punës dhe po ashtu ka kërkuar që PTK-ja ta kthejë parashtruesin në vendin e punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, nga data e suspendimit të tij nga puna më 9 qershor 2006 deri në kthimin e tij në punë.
13. Më 4 qershor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. l. nr. 426/06, në tërësi kishte pranuar padinë dhe kërkësepadinë si të bazuar.
14. Më 31 janar 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 18/2008, refuzoi ankesën e së paditurës PTK si e pabazuar si dhe vërtetoi Aktgjykimin C. l. nr. 426/06, të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
15. Më 15 mars 2011, e paditura PTK ka parashtruar revizion kundër Aktgjykimit të shkallës së dytë, Ac. nr. 18/2008.
16. Më 14 prill 2011, e paditura PTK i është drejtuar Gjykatës Komunale në Prishtinë, për Gjykatën Supreme, me të cilën shkresë e paditura tërheq revizionin e paraqitur më 15 mars 2011. Megjithatë, Gjykata Komunale nuk ia ka dorëzuar këtë shkresë Gjykatës Supreme.
17. Prandaj, më 15 mars 2013, Gjykata Supreme, duke mos ditur për shkresën për tërheqjen e revizionit, me Aktgjykimin Rev. nr. 82/2011, ka pranuar revizionin e së paditurës PTK dhe është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 18/2008, i 31 janarit 2011, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. l. nr. 426/2006, i 4 qershorit 2007, kështu që është refuzuar padia dhe kërkësepadia e parashtruesit si e pabazuar.
18. Më 8 maj 2013, parashtruesi ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës në Gjykatën Supreme. Megjithatë, parashtruesi këtë fakt nuk e kishte përfshirë në kërkësën e tij të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, më 31 maj 2013. Për më tepër, parashtruesi pohoi se ai nuk mund ta shfrytëzonte këtë mjet juridik.
19. Më 13 nëntor 2013, Gjykata Supreme, me Aktvendimin PPC. nr. 6/2013, e ka lejuar kërkësën e parashtruesit për përsëritjen e procedurës dhe e ka anuluar Aktgjykimin Rev. nr. 82/11, të 15 marsit 2013, si dhe ka konstatuar se revizioni

është tërhequr dhe e ka lënë në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 18/2008.

## Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi i kérkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës si dhe nga neni 6 i KEDNJ-së, si rezultat i vendimmarrjes nga Gjykata Supreme në revizion, pavarësisht nga tërheqja e kérkesës për revizion nga parashtruesi i saj.

## Pranueshmëria e kérkesës

21. Në mënyrë që të jetë në gjendje ta shqyrtojë kérkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kérkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohet më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 32 (4) të Rregullores së punës, ku përcaktohet se “*Gjykata mund të hedhë poshtë një kérkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest*”.
23. Gjykata konsideron se nxjerra e Aktvendimit PPC. nr. 6/2013, të Gjykatës Supreme, të 13 nëntorit 2013, me të cilin është lënë në fuqi aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, tregon se pozita e parashtruesit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme dhe që kérkesa e tij tanimë nuk ka arsyetim, si dhe qëllimi që ka kérkuar të arrijë parashtruesi, është arritur plotësisht.
24. Gjithashtu, Gjykata merr parasysh shkresën e parashtruesit të 23 janarit 2014 për tërheqjen e kérkesës së tij, pasi që parashtruesi tani nuk ka rast apo kontest të pazgjidhur në lidhje me kushtetutshmërinë e vendimit të Gjykatës Supreme, Aktgjykimi Rev. nr. 82/2011, i 15 marsit 2013, dhe çështja është pa objekt shqyrtimi.
25. Për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, shqyrtimi i mëtejshëm i kérkesës ndërpritet dhe Gjykata konstaton që nuk ka rrethana të posaçme lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat do të kërkonin shqyrtim të mëtejshëm të kérkesës (shih, *mutatis mutandis*, Rasti Nr. KIo6/13, parashtruesi: *Sylejman Mustafa*, Aktvendimi për papranueshmëri i 21 nëntorit 2013).
26. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (4) të Rregullores së punës, kérkesa e parashtruesit hiqet nga lista.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (4) të Rregullores së punës, më 11 mars 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA HEQË kërkesën nga lista dhe të mos ndërmarrë masa të tjera lidhur me të;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**



Arta Rama-Hajrizi



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani